



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

Numri i kontratës: 101-24-10972-1-3-6/C152

KUVENDI REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe

A.R.F SHPK, Fushë Kosovë (Adresa: Xhevë Lladrovci, Tel. +383 45 501 110; E-mail: arfshpk.a@gmail.com; NUI: 811255109) (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me material për konferenca

Numri i prokurimit: 101-24-10972-1-3-6 (KU101 24 040 136)

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizimi me material për konferenca – dhurata simbolike

Furnizimi me material për konferenca

Emra për konferenca - formati A4, Emra të personalizuar për tavolina protokollare, varëse për mbajtje të ID kartelave, bexha të materialit plastik, stilolapsa ekskluziv-schneider ose ekuivalent, fletore me kopertina të plastifikuara -formati A5, fasiklla me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me logo të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, çanta krahu tekstili.

1.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë para aktivitetit. Sesi i XXXVI-të i Asamblesë Rajonale të Evropës (ARE) të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), që do të mbahet prej datës 10-14 nëntor 2024 në Prishtinë.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë – **Kuvendi i Republikës së Kosovës**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **945.00 €** (*nëntëqind e katërdhjetë e pesë euro*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat, ose të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve, shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e

njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [*specifiko gjykatën kompetente*] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.




KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Afatet kohore	1.3	<ul style="list-style-type: none"> Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me implementimin e Kontratës. Afati kohor i përfundimit - Furnizimi me material për konferenca nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë para aktivitetit. Sesioni i XXXVI-të i Asamblesë Rajonale të Evropës (ARE) të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), që do të mbahet prej datës 10-14 nëntor 2024 në Prishtinë.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<ul style="list-style-type: none"> Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Pagesa	4	<ul style="list-style-type: none"> Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë
Cilësia e furnizimeve	6	<ul style="list-style-type: none"> Të gjithë artikujt duhen të jenë në pajtim me kërkesat e specifikacionin teknik në Dosje të Tenderit Artikujt që nuk janë funksional sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktues do t'i kthehen operatorit ekonomik edhe pas pranimit të tyre.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	13.1	<ul style="list-style-type: none"> Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.2	<ul style="list-style-type: none"> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim:

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare të Operatorit ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Operatori Ekonomik A.R.F. SHPK	
Emri dhe mbiemri	Xhemail Halili	Emri dhe mbiemri	Milozim Meha
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Përgjegjës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.11.2024	Data:	07.11.2024
Vula:		Vula:	








Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Titulli: FURNIZIMI ME MATERIAL PËR KONFERENCA
Nr. i Prokurimit: 101-24-10972-1-3-6 dhe Nr. i Brendshëm: KU101 24 040 136

PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

Nr.	Artikulli	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Totali
1	Emra për konferenca Formati A4	Furnizim me emra për konferenca - Emrat duhet të punohen nga letra kualitative 300 gr me ngjyrë të bardhë dhe duhet të jenë të formatit A4. Emri duhet të printohet në të dy anët e letrës.	copë	150.00	0.20	30.00
2	Emra të personalizuar për tavolina protokollare	Furnizim me emra të personalizuar për tavolina protokollare (përshkrimi: emri mbiemri, pozita, shteti), Dimensionet (10x 5 cm) toleranca +- 10 %. Emri duhet të printohet në të dy anët e letrës.	copë	150.00	0.10	15.00
3	Varëse për mbajtje të ID kartelave	Varëse për mbajtje të ID kartelave - varëse të gatës nga material bez shiritor me ngjyrë të bardhë 120 copë) dhe me ngjyrë të kuqe 30 copë). Dim 80 cm (toleranca +-10 %)	copë	150.00	0.60	90.00
4	Bexha të materialit plastik	Bexha të materialit plastik. Dimensioni i printimit 2.13x3.39 inç. ose me dim (9x6) cm, me toleranca +- 10%, e personalizuar - me mbi shkrim (emri i aktivitetit, emri i seksionit nga vjen mysafiri, pozita, vendi dhe data e mbajtjes së aktivitetit), me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me logo të APF (formati i fotos me ngjyrë).	copë	150.00	0.50	75.00
5	Stirolapsa ekskluziv Schneider ose ekuivalent	Stirolapsa ekskluziv- Schneider ose ekuivalent me shtyp njëanësor me logo të Kuvendit dhe me tekstin Kuvendi i Kosovës në tre gjuhët: Gjuhë shqipe, serbe dhe angleze	copë	150.00	0.30	45.00

6	<p>Fletore me kopertina të plastifikuara Formata A5</p>	<p>Furnizim me fletore për shënime me format A5, kopertina të plastifikuara, 100 flete, me strukturë njëngjyëshe të bardha, logo dhe mbishkrimi (Kuvendi i Republikës së Kosovës), shtypja e logos së Kuvendit duhet të jetë ngjyre ari dhe në tri (3) gjuhë (shqip, anglisht, serbisht) dimensionet 14X20,5 (dizajni i veçantë, si në foto),</p>		<p>copë</p>	<p>150.00</p>	<p>1.90</p>	<p>285.00</p>
7	<p>Fasiklla me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me logo të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë</p>	<p>Furnizimi me fasiklla të brenduar të cilët duhet të punohen nga letra kualitative 300 gr, me logo të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me logo të APF (fotot e logo-ve gjeni ne foto), e shtypur me format A4.</p>	<p>Logo e KK:</p>  <p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Kuvendi – Skupština – Assembly dhe me Logo të APF</p> 	<p>copë</p>	<p>150.00</p>	<p>0.60</p>	<p>90.00</p>

	<p>Çanta krahu (tekstili) me dimensione 35x40 cm, ngjyrë e bardhë, me mbishkrim:</p> <p>XXXVIe SESSION de l'Assemblée régionale Europe (ARE) de l'Assemblée parlementaire de la Francophonie (APF) Pristina, 10 et 14 novembre 2024</p> <p>Assemblée de la République du Kosovo</p> <p>me dizajn dhe me ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktues (dizajni dhe me ngjyra si në foto) për seminarin ARE Prishtina 2024 aktiviteti i bashkëorganizuar në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë</p>   <p>NOUVEAU SESSION de l'Assemblée régionale Europe (ARE) de l'Assemblée parlementaire de la Francophonie Pristina, 10 et 14 novembre 2024</p> <p>Assemblée de la République du Kosovo</p>	copë	150.00	2.10	315.00
Furnizimi me material për konferenca-Totali me TVSH-në					945.00

- Shënimi:**
- Për shkak të natyrës specifike të aktiviteteve punimi i artikujve dedikuar konferencës bëhet nga furnizuesi (operatori ekonomik) në bashkëpunim me autoritetin kontraktues
 - Emrat e e pjesëmarrësveve sipas shteteve do të dërgohen furnizuesit (operatori ekonomik) pas nënshkrimit të kontratës.
 - Furnizimi me artikuj nga ana e operatorit ekonomik duhet të bëhet jo më vonë se tri ditë para aktiviteteve.

Shënim:

Operatorët ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për artikujt e ofruar.

Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	ARF SHPK
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:	Resmi Koca
Nënskrimi:	
Vula:	
Data:	28.10.2024